



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/01-37195 dt. 31/08/ 2026



Bazuar në nenin 11, 12, 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34, pika 6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 Nr. 320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Rregullores MF-NR 04/2017 mbi Kritret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve, vendimit 01 Nr 020/04-17991, të dt. 19.05.2026, si dhe buxhetit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2026. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.08.2026 miratoi këtë:

V E N D I M
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1

Me këtë vendim, miratohet mbështetja financiare për projektin **“Intervenimi në fëmijërinë e herëshme, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe rehabilituese për fëmijët me kufizime fizike dhe të kombinuara”**, të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos”, lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve për vitin 2026.

Neni 2

Projekti i Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”- Intervenimi në fëmijërinë e herëshme, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe rehabilituese për fëmijët me kufizime fizike dhe të kombinuara, përkrahët në shumën prej 5.000 € (pesë mijë euro), mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2026.

Neni 3

Financimi - Subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike e shpenzimeve subvencione dhe transfere të parapara me Buxhetin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Neni 4

Mjetet financiare barten në konton e Shoqatës së Presonave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozimvendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ “HANDIKOS”, që të bëjë raport narrativ-me shkrim dhe financiar përmes zyrtarit monitorues në mënyrë që të njoftojë DSHMS-në për mënyrën e shpenzimit të mjeteve.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Bujupi

Arsyetimi

Bazuar në nenin 16 paragrafi 3, të Rregullorës MF-NR. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregullores Nr. 12/320-19338, të dt. 07.04.2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, është formuar komisioni me Vendimin 01 Nr 020/04-17991, të dt. 19.05.2026, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike Nr. 01-400/01-17062 dt. 12.05.2026, të shpallur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2026.

Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar aplikacionet e aplikantëve për subvencionim të OJQ-ve në bazë të thirrjes publike të lartëcekur, ku gjithsej kishin aplikuar dy (2) OJQ.

Meqë vlera e përkrahjes financiare në bazë të thirrjes publike është 5.000 €, kjo shumë do t'i ndahet OJQ-së që i ka plotësuar kriteret, financimi- subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere të parapara me Buxhetin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Komisioni i caktuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, gjatë zhvillimit të procedurës së ndarjes së subvencionit, nuk ka përgatitur propozim-vendim për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës, pasi në Rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, si dhe në aktet përkatëse që rregullojnë këtë procedurë, nuk është përcaktuar në mënyrë të shprehur obligimi që vendimi për ndarjen e subvencionit pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga Komisioni, të propozohet për miratim në Kuvendin e Komunës. Megjithatë, gjatë procedurës së realizimit të pagesës, lënda është kthyer nga procedura e pagesës, me arsyetimin se për realizimin e pagesës kërkohet vendim i miratuar nga Kuvendi i Komunës. Për këtë arsye, me qëllim të përfundimit të procedurës administrative dhe mundësimit të realizimit të pagesës për përfituesin e përcaktuar nga Komisioni, Drejtoria është e detyruar që çështjen ta procedojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA/VLADA/GOVERNMENT

MINISTRIA E FINANCËVE-MINISTARSTVO ZA FINANSIJE-MINISTRY OF FINANCE

Nr. Dokumenti: 02/KOMPL
Org. Jedimca: 1752-1/2026
Nr. Faqeve: 1
Dati: 10.09.26
Dol. Stranica: 1
No. pages: 1
PRISTINE/PRISTINA/PRISHTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo Finansija- Ministry of Finance

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit	
Kopje:	Burim Bujupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Hysni Mehani, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave Artan Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave	
Nga:	Bora Duli, Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave	Date: 07.09.2026
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Medina Millaku, Zyrtare e Lartë Ligjore për Hartim të Legjislacionit, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave	Referencë: 216/2026
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj, Udhëheqëse e Divizionit për Politika Buxhetore, Ministria e Financave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar z.Lladrovci,
I nderuari Kryesues z.Bujupi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 9 dhe 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

<i>Vendimi 02 Nr.400/01-37195 për financim të projektit të Shoqatës së personave me aftësi të kufizuara "HANDIKOS"</i>
<i>I miratuar më datë 31.08.2026</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 01.09.2026</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, më datë 04.09.2026</i>

Ministria e Financave (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërme të Komunës së Drenasit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Drenasit, me anë të vendimit që është subjekt i shqyrtimit, synon financimin e projektit të Shoqatës së personave me aftësi të kufizuara "HANDIKOS".
2. Në shqyrtimin e mundësisë së Komunës për realizimin e aktit administrativ komunal, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "LMFPP"). Po ashtu, është konsultuar Ligji Nr. 10/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.
3. Parimi i përgjithshëm i mishëruar në LMFPP është se çdo organizatë buxhetore, në shpenzim të parashë publike, duhet të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore të LMFPP-së, sikurse përcaktohet në nenin 3 të LMFPP-së.
4. Në përmbajtje të LMFPP-së, paratë publike përkufizohen si pasuri financiare ose para të cilat pranohen, janë nën përkujdesjen, mbahen në mirëbesim ose janë nën kontrollin e ndër tjerash, organizatave buxhetore.
5. Ndërsa, në kontekst të shpenzimit të parashë publike, neni 17 i LMFPP-së përcakton se shpenzimi i parave publike nga organizatat buxhetore mund të bëhet vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe nga fondet e ndara dhe të alokuara [theks i shtuar].
6. Nisur mbi këtë bazë, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, ku është evidentuar se organizata buxhetore i ka të planifikuara shpenzimet e potencuara me aktin komunal për vitin 2026 fiskal.

7. Poashtu, gjatë shqyrtimit të akteve komunale, Ministria ka evidentuar se përfituesi i subvencionit kanë statusin e Organizatës Jo-Qeveritare (OJQ) në Sistemin Elektronik të Organizatave Jo-Qeveritare (SEOJQ).
8. Për financimin publik të OJQ-ve, në gamën legislative të Ministrisë evidentohen si relevante dispozitat ligjore të Rregullores Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardët dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve (këtë e tutje referuar si 'Rregullore për Financimin e OJQ-ve'). Rrjedhimisht, dispozitat e kësaj Rregullore janë të zbatueshme dhe relevante për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit komunal në këtë vit fiskal.
9. Nga dokumentacioni i bashkëngjitur Vendimit rezultoi se komuna ka paraqitur edhe arsyetimin lidhur me ndarjen e mjeteve financiare, duke theksuar se procedura e përzgjedhjes së përfituesve është zhvilluar në bazë të Thirrjes Publike të datës 12.05.2026.
10. Andaj, si përfundim, dhe duke marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria e Financave evidenton se akti komunal i Komunës së Drenasit është nxjerrë konform legjislacionit në fuqi.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit, dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Më respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave